



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Udhëzues Pune i Zyrës Administrative

Direktivë për Mbrojtësit

Miratoi: Administratorja, Dhoma e Specializuarë të Kosovës

Data e miratimit: 28 prill 2021

Data e hyrjes në fuqi: 28 prill 2021

Zëvendëson: KSC-BD-04

Numri: KSC – BD -04-Rev1

Përmbajtja

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
PJESA 1 QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI	2
PJESA 2 PËRKUFIZIME	3
PJESA 3 NDRYSHIMET	4
PJESA 4 VERSIONI AUTENTIK DHE HYRJA NË FUQI	4
KAPITULLI II LISTA E MBROJTËSVE	4
PJESA 5 KRITERET E PRANIMIT NË LISTËN E MBROJTËSVE	4
PJESA 6 KËRKESA PËR PRANIM NË LISTËN E MBROJTËSVE	5
PJESA 7 PROCEDURA DHE VENDIMI MBI PRANIMIN	6
PJESA 8 RISHIKIMI I VENDIMIT NË BAZË TË PJSËS 7.4.	6
PJESA 9 DETYRIMET NË VIJIMËSI	7
PJESA 10 HEQJA OSE PEZULLIMI NGA LISTA E MBROJTËSVE	7
PJESA 11 RISHIKIMI I VENDIMIT TË MARRË SIPAS PJSËS 10	8
KAPITULLI III EMËRIMI DHE CAKTIMI I MBROJTËSVE	8
PJESA 12 EMËRIMI DHE CAKTIMI	8
PJESA 13 EMËRIMI I MBROJTËSVE NGA LISTA E MBROJTËSVE TË SPECIALIZUAR	8
PJESA 14 CAKTIMI I MBROJTËSVE NGA LISTA E MBROJTËSVE TË SPECIALIZUAR	9
PJESA 15 CAKTIMI I MBROJTËSIT TË NJË GRUPI VIKTIMASH	9
PJESA 16 PËRFUNDIMI I PËRFAQËSIMIT	10
PJESA 17 CAKTIMI I MBROJTËSIT KUJDESTAR	10
PJESA 18 EKIPI DHE DETYRIMET E MBROJTËSIT	10

KAPITULLI I Dispozita të përgjithshme**Pjesa 1 Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Kjo Direktivë është miratuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 23(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ("Rregullorja"). Kjo Direktivë dhe çdo ndryshim i saj interpretohen në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren.
2. Në pajtim me nenin 34(6) dhe (7) të Ligjit dhe në bazë të rregullës 25 të Rregullores, kjo Direktivë rregullon kriteret e pranueshmërisë, përgatitjen profesionale dhe përvojën e nevojshme për përfshirje në Listën e Mbrojtësve, si dhe modalitetet e tërheqjes dhe të heqjes nga Lista e Mbrojtësve.
3. Në përputhje me nenin 21(4)(e) dhe 22(5) të Ligjit dhe rregullën 26 të Rregullores, kjo Direktivë përcakton procedurën për emërimin dhe caktimin e mbrojtësve, si dhe procedurën e tërheqjes dhe të përfundimit të emërimit ose caktimit të mbrojtësve.
4. Kjo Direktivë është e zbatueshme për të gjithë personat që bëjnë kërkesë për t'u pranuar në Listën e Mbrojtësve, të gjithë mbrojtësit e pranuar në Listën e Mbrojtësve dhe të gjithë mbrojtësit e emëruar ose të caktuar nga Administratori. Për atë që ka lidhje me përfaqësimin e tyre juridik, kjo Direktivë zbatohet edhe për të dyshuarit, të akuzuarit, për personat të cilëve u është miratuar

statusi si viktimë sipas rregullës 113 të Rregullores, si edhe për këdo tjetër që gëzon të drejtën e përfaqësimit juridik në bazë të Ligjit, Rregullores, ose në bazë të urdhrit të një paneli.

Pjesa 2 Përkufizime

1. Në kontekstin e kësaj Direktive dhe nëse nuk saktësohet ndryshe në pjesën 2(2) të saj, termat e përdorura këtu kanë kuptimin që u jepet në rregullën 2 të Rregullores. Njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas.

2. Krahas tyre, përdoren edhe përkufizimet e mëposhtme:

Parashtrues i kërkesës	Person fizik që bën kërkesë për t'u përfshirë në Listën e Mbrojtësve, në përputhje me Kapitullin II të kësaj Direktive;
Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit	Kodi i Etikës Profesionale – për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës miratuar nga Administratorja në bazë të nenit 34(3) të Ligjit dhe rregullës 23(3) të Rregullores;
Mbrojtës	Person i cili përfaqëson, ose plotëson kriteret e përfaqësimit të një të akuzuari, të dyshuari, ose të një grupi viktimash pjesëmarrëse, ose të një personi tjetër në bazë të kësaj Direktive;
Bashkëmbrojtës	Person në Listën e Mbrojtësve i zgjedhur prej mbrojtësit si bashkëmbrojtës në bazë të pjesës 18(1), ose një person i cili i përmbush kriteret si bashkëmbrojtës në bazë të kësaj Direktive.
Zyra e Mbrojtjes	Njësi e Zyrës Administrative e paraparë në nenin 34(7) të Ligjit dhe rregullën 23(6) të Rregullores;
Mbrojtës kujdestar	Mbrojtës i cili ka informuar kreun e njësisë përkatëse të Zyrës Administrative në përputhje me pjesën 6.2.b. të kësaj Direktive, se është i gatshëm të paraqitet brenda një kohe të shkurtër dhe për një detyrë ose detyra të kufizuara;
Kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative	Shefi i Zyrës së Mbrojtjes ose shefi i Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave, sipas rastit;
Rregullorja e Ndhmës Juridike	Rregullore mbi caktimin e mbrojtësve në kuadër të ndihmës juridike miratuar prej Administratorës në bazë të nenit 34(6) dhe (7) të Ligjit;
Lista e Mbrojtësve	Listë që përfshin mbrojtësit e specializuar ose mbrojtësit e viktimave, sipas rastit;
Lista e Mbrojtësve të Specializuar	Lista e mbrojtësve të cilët përmbushin kriteret për përfaqësimin e të dyshuarve ose të akuzuarve para Dhomave të Specializuara;
Lista e Mbrojtësve të Viktimave	Lista e mbrojtësve të viktimave që përmbushin kriteret për ushtrimin e profesionit para Dhomave të Specializuara

Administrator

Administratori i Dhomave të Specializuara,
emëruar në bazë të nenit 34(4) të Ligjit;

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave

Njësi e Zyrës Administrative, e paraparë në
nenin 34(6) të Ligjit dhe rregullën 23(5) të
Rregullores.

Pjesa 3 Ndryshimet

1. Administratori mund ta ndryshojë Direktivën *proprio motu* ose mbi bazën e një propozimi për ndryshim në bazë të rregullës 23(3). Cilido prej gjykatësve, Organi Përfaqësues i Pavarur i Mbrojtësve të Specializuar dhe deri në krijimin e këtij organi, cilido mbrojtës përmes kreut të njësisë përkatëse të Zyrës Administrative, mund t'i paraqesin Administratorit propozime të arsyetuara për ndryshime. Administratori mund të këshillohet me Organin Përfaqësues të Pavarur të Mbrojtësve të Specializuar në lidhje me çdo propozim për ndryshim.
2. Administratori mban evidencën e procedurës së ndryshimit duke informuar për rezultatin paraqitësit e propozimeve për ndryshime. Sipas rastit, Administratori mund ta bëjë publike procedurën e ndryshimit (ose pjesë të saj).

Pjesa 4 Versioni autentik dhe hyrja në fuqi

1. Versioni autentik i kësaj Direktive është versioni në gjuhën angleze.
2. Kjo Direktivë e miratuar nga Administratori, si dhe çdo ndryshim i saj hyn në fuqi në ditën e publikimit.

KAPITULLI II Lista e Mbrojtësve

Pjesa 5 Kriteret e pranimi në Listën e Mbrojtësve

Në pajtim me rregullën 25(1) dhe (2) të Rregullores, parashtuesi i kërkesës duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme për pranim në Listën e Mbrojtësve:

- a. kompetencë dhe përvojë të dëshmuar në fushën e së drejtës dhe procedurës penale vendore dhe/ose në fushën e së drejtës dhe procedurës penale ndërkombëtare;
- b. së paku dhjetë (10) vjet dhe si bashkëmbrojtës, së paku shtatë (7) vjet përvojë të dëshmuar përkatëse, qoftë si avokat i mbrojtjes apo i viktimave, si prokuror, gjykatës, ose në një funksion të ngjashëm në procese penale;
- c. për pranim në Listën e Mbrojtësve të Viktimave, në kriterin e pjesës 5.b, përfshihet së paku pesë (5) vjet përvojë pune e dëshmuar në çështje penale me viktimë, përfshirë viktimë të cenueshme;
- d. gjatë gjithë kohës që është i përfshirë në Listën e Mbrojtësve, parashtuesi i kërkesës vazhdon të jetë anëtar i shoqatës së avokatëve ose i një institucioni të ngjashëm të vendit të tij, ose gjykatës dhe prokuror në varësi të një autoriteti mbikëqyrës;
- e. aftësi të komunikimit me shkrim dhe me gojë në një nga gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara, sikurse përcaktohet në nenin 20 të Ligjit;

- f. nuk është shpallur fajtor në procese penale, ose ndaj tij ose saj nuk janë marrë masa disiplinore në procedime disiplinore përkatëse kundër tij ose saj në ndonjë forum shtetëror ose ndërkombëtar, duke përfshirë edhe çfarëdo procedimi në bazë të kodeve të etikës profesionale të gjykatave ndërkombëtare, përveç nëse gjykohej që, në rrethana të caktuara, do të ishte e tepruar që të refuzohej pranimi mbi këtë bazë; dhe
- g. gjatë ushtrimit të profesionit ose në rrethana të tjera nuk ka pasur sjellje të pandershme ose diskredituese për një mbrojtës, në dëm të administrimit të drejtësisë, ose që ka gjasë të pakësojë besimin e publikut në Dhoma e Specializuarë, ose në administrimin e drejtësisë, ose që diskrediton emrin e Dhomave të Specializuara.

Pjesa 6 Kërkesa për pranim në Listën e Mbrojtësve

1. Për pranim në Listën e Mbrojtësve, parashtruesi i kërkesës i paraqet kreut të njësisë përkatëse të Zyrës Administrative;
 - a. formularin e plotësuar të kërkesës (Shtojca A);
 - b. një vërtetim në lidhje me përmbushjen e kriterëve të pjesës 5.d. të kësaj Direktive dhe ku përmendet çfarëdo mase disiplinore ose procedim disiplinor në kryerje e sipër, nëse ka;
 - c. vërtetime plotësuese që konfirmojnë kualifikimet, anëtarësinë ose faktin se ka qenë pjesëtar i personelit dhe ku ndër të tjera përmendet çfarëdo mase disiplinore ose procedim disiplinor në kryerje e sipër nëse ka, lëshuar ndër të tjera nga;
 - (1) shoqata shtetërore e avokatëve ose një institucion i ngjashëm anëtar i së cilës ka qenë parashtruesi i kërkesës dhe/ose nga autoriteti mbikëqyrës i mëparshëm ose autoritetet mbikëqyrëse të mëparshme të parashtruesit të kërkesës;
 - (2) një shoqatë ndërkombëtare avokatësh ose një organizatë apo institucion ndërkombëtar apo i ndërkombëtarizuar që mban një listë mbrojtësish ku parashtruesi i kërkesës është apo ka qenë anëtar; dhe/ose
 - (3) një instancë ose organizatë vendore, ose një organizatë apo institucion ndërkombëtar apo i ndërkombëtarizuar ku parashtruesi i kërkesës është, ose ka qenë pjesëtar i personelit.
 - d. një vërtetim të lëshuar nga autoriteti përkatës i çdo shteti shtetas i të cilit është personi dhe/ose ku personi është me banim, që përmend çfarëdo vendimi për fajësi penale nëse ka;
 - e. të gjithë informacionin përkatës që nuk përmendet në pjesën 6.1b-d, në lidhje me çfarëdo mase disiplinore ose procedim disiplinor në kryerje e sipër, ose në lidhje me çfarëdo hetimi ose verifikimi tjetër të sjelljes sipas pjesës 5.g. dhe çfarëdo procedimi penal në kryerje e sipër kundër parashtruesit të kërkesës;
 - f. prova të aftësisë gjuhësore siç kërkohet në pjesën 5.e. të kësaj Direktive, ndër të tjera, përmes dokumentimit të përvojës së punës dhe/ose një vërtetimi nga një institut gjuhësor;
 - g. emrat dhe adresat e dy rekomanduesve të cilët ushtrojnë profesionin në fushat përkatëse dhe që janë në gjendje të japin informacion për kompetencat profesionale të parashtruesit të kërkesës në këto fusha; dhe
 - h. çdo dokument tjetër përkatës që parashtruesi i kërkesës e çmon të nevojshëm.
2. Krahas këtyre, parashtruesi i kërkesës dorëzon:
 - a. një deklaratë në lidhje me disponueshmërinë e vet,

- b. një deklaratë të gatishmërisë për t'u paraqitur si mbrojtës kujdestar,
 - c. në lidhje me pranimin në Listën e Mbrojtësve të Specializuar, një deklaratë të gatishmërisë për të vepruar si mbrojtës i emëruar apo i caktuar, apo të dyja,
 - d. një deklaratë se pas emërimit ose caktimit, do t'i përmbahet Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit,
 - e. në lidhje me pranimin në Listën e Mbrojtësve të Viktimave, një deklaratë të gatishmërisë për të përfaqësuar një grup viktimash në procese penale para Dhomave të Specializuara.
3. Me dorëzimin e formularit të kërkesës në përputhje me pjesën 6.1.a. parashtruesi i kërkesës deklaron se Zyra Administrative mund të kryejë verifikimin e të gjitha deklaratave dhe informacionit mbështetës të dorëzuar.

Pjesa 7 Procedura dhe vendimi mbi pranimin

1. Kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative konfirmon marrjen e dokumentacionit të dorëzuar në përputhje me pjesën 6 të kësaj Direktive dhe nëse është e nevojshme, mund të kërkojë informacione plotësuese nga parashtruesi i kërkesës dhe/ose burime të tjera.
2. Pas këshillimeve me Administratorin, për raste të ngutshme kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative mund të miratojë pranimin e kushtëzuar të parashtruesit të kërkesës në listën përkatëse, në pritje të vendimit përfundimtar sipas kësaj pjese dhe, në veçanti, nëse parashtruesi i kërkesës aktualisht është në një listë të mbrojtësve të një gjykate apo tribunali me kriter pranimi të ngjashme.
3. Në qoftë se bindet se parashtruesi i kërkesës i përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në pjesën 5 dhe pjesën 6 të kësaj Direktive, kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative e pranon parashtruesin e kërkesës në Listën e Mbrojtësve. Nëse kundër parashtruesit të kërkesës është nisur procedim, hetim ose verifikim në përputhje me pjesën 6.1. kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative e shtyn vendimin mbi pranimin deri në vendimin e formës së prerë prej procedurave të përmendura më parë.
4. Në qoftë se parashtruesi i kërkesës nuk i përmbush të gjitha kriteret e pjesës 5 dhe pjesës 6 të kësaj Direktive, kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative nxjerr një vendim të arsyetuar që refuzon kërkesën e parashtruesit për pranim në Listën e Mbrojtësve.
5. Kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative e njofton parashtruesin e kërkesës për çdo vendim që merret sipas kësaj pjese.

Pjesa 8 Rishikimi i vendimit në bazë të pjesës 7.4.

1. Parashtruesi i kërkesës mund t'i paraqesë Administratorit kërkesë për rishikimin e vendimit të marrë sipas pjesës 7.4. të kësaj Direktive brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga njoftimi i vendimit. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e kërkesës për rishikim, Administratori nxjerr një vendim të arsyetuar të formës së prerë (në lidhje me kërkesën) dhe, nëse është e zbatueshme, udhëzon kreun e njësisë përkatëse të Zyrës Administrative ta pranojë parashtruesin e kërkesës në Listën e Mbrojtësve.
2. Parashtruesi i kërkesës mund të dorëzojë një kërkesë të re për pranim në Listën e Mbrojtësve vetëm në rast ndryshimi të rrethanave në lidhje me kriteret e pjesës 5 dhe pjesës 6.

Pjesa 9 Detyrimet në vijimësi

1. Pas pranimit në Listën e Mbrojtësve, mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi njofton pa vonesë të papërligjur kreun e njësisë përkatëse të Zyrës Administrative në lidhje me ndryshimin e të dhënave të kontaktit, nisjen e çfarëdo procedimi penal ose disiplinor vendor ose ndërkombëtar dhe për çfarëdo ndryshimi të informacionit të dhënë për pranim në Listën e Mbrojtësve, përpos ndryshimeve minimale. Me caktimin ose emërimin e vet, mbrojtësi informon për nisjen e çfarëdo procedimi penal ose disiplinor vendor ose ndërkombëtar edhe personin të cilin përfaqëson.
2. Në çdo rast, mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi në Listën e Mbrojtësve njofton menjëherë kreun e njësisë përkatëse të Zyrës Administrative në rast se nuk i plotëson më kriteret e pjesës 5 të kësaj Direktive dhe në rast se ka ndryshim, sipas pjesës 6.2. të kësaj Direktive.

Pjesa 10 Heqja ose pezullimi nga Lista e Mbrojtësve

1. Kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative e heq mbrojtësin ose bashkëmbrojtësin nga Lista e Mbrojtësve pasi t'i ketë dhënë mbrojtësit ose bashkëmbrojtësit mundësinë për t'u dëgjuar, sipas rrethanave nëse:
 - a. mbrojtësit ose bashkëmbrojtësit i është ndaluar përgjithmonë të ushtrojë profesionin para Dhomave të Specializuara si rezultat i procedimit disiplinor të zhvilluar në pajtim me Kodin e Etikës Profesionale për Mbrojtësit;
 - b. është konstatuar se mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi nuk i plotëson më kriteret për të përfaqësuar një të dyshuar, të akuzuar, ose viktimat pjesëmarrëse në proceset para Dhomave të Specializuara në përputhje me rregullën 63(1)(c) dhe/ose rregullën 64 të Rregullores;
 - c. mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi nuk i plotëson më kriteret e përcaktuara në pjesën 5 të kësaj Direktive; ose
 - d. mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi bën kërkesë për heqje nga Lista e Mbrojtësve.
2. Kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative e pezullon mbrojtësin ose bashkëmbrojtësin nga Lista e Mbrojtësve, nëse mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi është pezulluar për kohësisht nga ushtrimi i profesionit para Dhomave të Specializuara në procedim disiplinor, në bazë të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit.
3. Pasi t'i ketë dhënë mbrojtësit ose bashkëmbrojtësit mundësinë për t'u dëgjuar, kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative mund ta heqë ose pezullojë mbrojtësin ose bashkëmbrojtësin nga Lista e Mbrojtësve, nëse mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi:
 - a. ka dhënë informacion të rremë në lidhje me kriteret e pjesës 5 dhe pjesës 6 të kësaj Direktive, ose nuk ka dhënë informacionin përkatës sipas pjesës 9 të kësaj Direktive; ose
 - b. ka dhënë informacion të rremë në kuadër të caktimit sipas Rregullores së Ndihmës Juridike.
4. Nëse mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi është shpallur fajtor për një vepër penale kundër administrimit të drejtësisë sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe paneli ka vendosur që mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi të hiqet ose pezullohet nga Lista e Mbrojtësve, kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative procedon në përputhje me pjesën 10.1 ose 10.2, në përputhje me urdhrin e panelit.
5. Nëse mbrojtësi përkatës është i emëruar ose i caktuar në një çështje gjyqësore, në fillim duhet të përfundojë përfaqësimi sipas pjesës 16 të kësaj Direktive, e më pas mbrojtësi hiqet apo pezullohet nga Lista e Mbrojtësve.

6. Çdo vendim i marrë në bazë të pjesës 10.1-3, është i arsyetuar dhe i njoftohet menjëherë mbrojtësit ose bashkëmbrojtësit.

Pjesa 11 Rishikimi i vendimit të marrë sipas pjesës 10

Mbrojtësi ose bashkëmbrojtësi mund të bëjë kërkesë për rishikimin e vendimit të marrë nga Administratori sipas pjesës 10 të kësaj Direktive brenda katërmëdhjetë (14) ditësh prej këtij njoftimi. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e kërkesës për rishikim, Administratori jep një vendim të arsyetuar të formës së prerë në lidhje me të.

KAPITULLI III Emërimi dhe caktimi i mbrojtësve

Pjesa 12 Emërimi dhe caktimi

1. Në bazë të rregullës 26(1) të Rregullores, Administratori emëron ose cakton mbrojtës nga Lista e Mbrojtësve të Specializuar për një të dyshuar ose të akuzuar. Administratori:
 - a. emëron mbrojtësin e zgjedhur për të dyshuar ose të akuzuar që kanë mjete financiare të mjaftueshme për të marrë në shërbim mbrojtës;
 - b. i cakton mbrojtës një të dyshuari ose të akuzuari të cilit i mungojnë plotësisht, ose pjesërisht mjetet financiare për pagesën e mbrojtësit, nëse provohet se është plotësisht ose pjesërisht i varfër, në përputhje me Rregulloren e Ndihmës Juridike.
 - c. cakton mbrojtës për të dyshuar ose të akuzuar që nuk kanë zgjedhur mbrojtës, kur përfaqësimi është i detyrueshëm sipas nenit 21(5), të Ligjit; ose
 - d. cakton mbrojtës për të dyshuar ose të akuzuar për të mundësuar përfaqësim të efektshëm.
2. Në bazë të rregullës 26(2), të Rregullores, Administratori cakton mbrojtës nga Lista e Mbrojtësve të Viktimave për përfaqësimin e përbashkët të një grupi viktimash.
3. Administratori zbaton dispozitat e këtij kapitulli *mutatis mutandis* për çdo person tjetër i cili gëzon të drejtën e përfaqësimit juridik në bazë të Ligjit, të Rregullores, ose në bazë të urdhrit të një paneli sipas Ligjit ose Rregullores.
4. Në vendimin e emërimit ose caktimit të një mbrojtësi, Administratori merr parasysh çfarëdo gjuhe ose gjuhësh pune e cila ose të cilat janë përcaktuar në bazë të nenit 20 të Ligjit.
5. Në pajtim me nenin 28(3)(a) dhe 4(a) të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit, Administratori nuk e emëron ose cakton mbrojtësin, nëse mbrojtësi është duke këshilluar, përfaqësuar ose vepruar, ose ka këshilluar, përfaqësuar ose vepruar në emër të një klienti tjetër në të njëjtën çështje para Dhomave të Specializuara. Në lidhje me çfarëdo konflikti tjetër interesash të përmendur në nenin 28(3)(b)-(e) të Kodit Profesional për Mbrojtësit, para se të emërojë ose caktojë mbrojtësin, Administratori ia referon çështjen për vendim panelit përkatës. Deri në vendimin e panelit, Administratori mund të marrë masa të përkohshme për të garantuar përfaqësimin, kur diktohet prej interesave të drejtësisë.

Pjesa 13 Emërimi i mbrojtësve nga Lista e Mbrojtësve të Specializuar

1. I dyshuari ose i akuzuari që dëshiron të marrë në shërbim mbrojtës me fondet e veta, përmes Zyrës së Mbrojtjes i dorëzon Administratorit kërkesën për emërimin e mbrojtësit të zgjedhur.

2. Në pajtim me pjesën 12, mbrojtësi i zgjedhur emërohet për përfaqësimin e të dyshuarit ose të akuzuarit, në qoftë se është në Listën e Mbrojtësve të Specializuar dhe vazhdon të plotësojë kriteret e pjesës 5 të kësaj Direktive, ose është gjykuar se i përmbush kriteret e pranimit në Listën e Mbrojtësve të Specializuar.
3. Në rast se refuzon kërkesën për emërimin e një mbrojtësi, Administratori njofton të dyshuarin ose të akuzuarin, si edhe mbrojtësin e zgjedhur.
4. Në pajtim me rregullën 26(1), të Rregullores, i dyshuari ose i akuzuari mund t'i bëjë kërkesë panelit përkatës për rishikimin e vendimit të Administratorit sipas pjesës 13.3 të kësaj Direktive brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga njoftimi i vendimit.

Pjesa 14 Caktimi i mbrojtësve nga Lista e Mbrojtësve të Specializuar

1. I dyshuari ose i akuzuari të cilit i mungojnë plotësisht ose pjesërisht mjetet financiare për marrjen në shërbim të mbrojtësit, përmes Zyrës së Mbrojtjes i dorëzon Administratorit kërkesën për caktim të mbrojtësit.
2. Rregullorja e Ndhmës Juridike përmban procedurat konkrete në lidhje me vendimin e Administratorit mbi kërkesën për caktimin e mbrojtësit, përfshirë edhe rishikimin e vendimit sikurse përcaktohet në rregullën 26(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.
3. Në pritje të caktimit të mbrojtësit, Administratori mund të bëjë caktim të kushtëzuar të një mbrojtësi sipas procedurës së parashtruar në Rregulloren e Ndhmës Juridike;
4. Në rast se përfaqësimi i një të dyshuari ose të akuzuari është i detyrueshëm në bazë të nenit 21(5) të Ligjit dhe:
 - a. i dyshuari ose i akuzuari nuk bën kërkesë për caktimin ose emërimin e mbrojtësit, refuzon të bashkëpunojë në lidhje me këtë ose e zgjat në mënyrë të paarsyeshme zgjedhjen e mbrojtësit; ose
 - b. Administratori vendos të mos i akordojë ndihmë juridike të dyshuarit ose të akuzuarit; Administratori informon panelin përkatës me qëllim që paneli të mund të marrë çdo masë të nevojshme.

Pjesa 15 Caktimi i mbrojtësit të një grupi viktimash

1. Pas përcaktimit të grupimit nga paneli përkatës sipas nenit 22(4) të Ligjit dhe rregullës 113(7), (8) të Rregullores, Administratori cakton mbrojtësin e viktimave nga Lista e Mbrojtësve të Viktimave për grupin përkatës të viktimave, si përfaqësuesin e përbashkët të tyre, në përputhje me procedurën e parashtruar në Rregulloren e Ndhmës Juridike duke marrë parasysh,
 - a. propozimin e shefit të Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave;
 - b. këshillimet me viktimat pjesëmarrëse në procedurë ku shprehen pikëpamjet dhe interesat e tyre; dhe
 - c. faktorë që kanë të bëjnë me konflikt të mundshëm interesash si edhe rrethana të tjera përkatëse.
2. Pas caktimit të mbrojtësit të viktimave, Administratori i informon viktimat për vendimin dhe u jep të dhënat përkatëse të kontaktit.

3. Pikat 1 dhe 2 të pjesës 15 zbatohen *mutatis mutandis* për caktimin e mbrojtësit nga Lista e Mbrojtësve të Viktimave në bazë të rregullës 113(6) të Rregullores.

Pjesa 16 Përfundimi i përfaqësimit

1. Gjatë shqyrtimit të përfundimit para kohe, ose të pezullimit të përfaqësimit në bazë të kësaj pjese, Administratori i kushton rëndësinë e duhur vazhdimin të përfaqësimit dhe duhet të marrë miratimin e panelit të ngarkuar me çështjen në të cilën vepron mbrojtësi. Paneli mund të urdhërojë masa të përkohshme në pritje të vendimit mbi çfarëdo apeli kundër miratimit.
2. Administratori e përfundon përfaqësimin nga mbrojtësi në rrethanat e mëposhtme:
 - a. është vërtetuar se ekziston konflikt interesi sipas Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit që pengon vazhdimin e përfaqësimit;
 - b. mbrojtësi, i dyshuari, i akuzuari, ose viktimat pjesëmarrëse në proces bëjnë kërkesë për tërheqje, duke dhënë arsye bindëse, ndër të cilat rastet kur është prishur marrëdhënia e besimit midis mbrojtësit dhe klientit të vet;
 - c. është provuar një nga arsyet për heqje ose pezullim nga Lista e Mbrojtësve të parashtruara në pjesën 10 të kësaj Direktive, me përjashtim të pjesës 10.1.d të kësaj Direktive; ose
 - d. marrëdhënia kontraktuese ndërmjet Zyrës Administrative dhe mbrojtësit në lidhje me caktimin ka përfunduar për arsyet e parashtruara në Rregulloren e Ndhmës Juridike.
3. Gjithashtu, Administratori mund ta pezullojë përfaqësimin nëse kundër mbrojtësit është nisur procedim disiplinor sipas Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit, nëse paneli përkatës e urdhëron këtë gjatë procesit gjyqësor sipas nenit 15(2) të Ligjit, ose nëse është i nevojshëm për integritetin e procesit sipas kushteve të përcaktuara në nenin 1(2) të Ligjit.
4. Në interes të drejtësisë, Administratori mund të udhëzojë që mbrojtësi i emëruar ose i caktuar përfaqësimi i të cilit do të përfundohet, të vazhdojë të veprojë ose të ndihmojë mbrojtësin zëvendësues për një periudhë jo më shumë se dyzet e pesë (45) ditë nga data e caktimit ose emërimit të mbrojtësit zëvendësues. Gjatë kësaj periudhe, shpenzimet e nevojshme dhe të arsyeshme të mbrojtësit që po largohet, mbulohen nga Dhoma e Specializuarë.

Pjesa 17 Caktimi i mbrojtësit kujdestar

1. Secili prej krerëve të njësive përkatëse të Zyrës Administrative mban një Listë të Mbrojtësve Kujdestarë.
2. Administratori cakton mbrojtës kujdestar për çështje të ngutshme dhe për një periudhë të kufizuar në përputhje me Rregulloren e Ndhmës Juridike.

Pjesa 18 Ekipi dhe detyrimet e mbrojtësit

1. Mbrojtësi i emëruar në bazë të pjesës 13 të kësaj Direktive mund të zgjedhë anëtarë të ekipit të vet, ndër të cilët një bashkëmbrojtës nga një listë mbrojtësish, në varësi të miratimit prej Administratorit. Mbrojtësi i caktuar në bazë të kapitullit III të kësaj Direktive mund të zgjedhë anëtarë të ekipit të vet në përputhje me Rregulloren e Ndhmës Juridike dhe këtë pjesë.

2. Në zgjedhjen e anëtarëve të ekipit të vet, mbrojtësi merr parasysh përvojën dhe kompetencën e tyre si edhe gjuhën ose gjuhët e punës të përcaktuara në përputhje me nenin 20 të Ligjit, si edhe çfarëdo konflikti faktik ose të mundshëm interesash përcaktuar në nenin 28 të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit.
3. Për miratimin prej Administratorit në bazë të pjesës 18.1, mbrojtësi dorëzon:
 - a. vërtetim se bashkëmbrojtësi i zgjedhur i plotëson kriteret e pjesës 5 të kësaj Direktive;
 - b. dokumentacion që tregon se secili anëtar i pritshëm i ekipit plotëson kriteret e pjesës 5.f dhe g, të kësaj Direktive, konkretisht vërtetime dhe informacion që kërkohen sipas pjesës 6.1.d dhe e, të kësaj Direktive;
 - c. një deklaratë me shkrim të nënshkruar nga secili anëtar i pritshëm i ekipit ku deklarohet se nuk ekziston asnjë konflikt faktik ose i mundshëm interesash; dhe
 - d. një zotim konfidencialiteti të nënshkruar prej anëtarit të pritshëm të ekipit që vihet në dispozicion nga kreu i njësisë përkatëse të Zyrës Administrative.
4. Bashkëmbrojtësi i zgjedhur ka kompetencë të nënshkruajë dokumente dhe të paraqitet në gjykatë në vend të mbrojtësit dhe të merret me të gjitha çështjet që dalin.
5. Nëse përfaqësimi ka përfunduar para kohe ose është pezulluar sipas pjesës 16 të kësaj Direktive, për arsye të vazhdimësisë dhe në këshillim me personin që përfaqësohet, përgjithësisht mbrojtësi zëvendësues përpiqet të vazhdojë përfaqësimin me anëtarët e ekipit të mbrojtësit të mëparshëm. Bashkëmbrojtësi mund të emërohet ose caktohet si mbrojtës zëvendësues, me përjashtim të rasteve kur nuk i plotëson kriteret përkatëse të pjesës 5, ose në qoftë se personi i përfaqësuar e kundërshton një zëvendësim të tillë, ose nëse ekzistojnë arsye të tjera serioze kundër zëvendësimit.
6. Nëse mendon ta përfundojë kontratën me bashkëmbrojtësin, mbrojtësi informon për këtë Administratorin dhe duhet të demonstrojë se përfundimi i kontratës mund të kryhet pa shkaktuar pasoja ligjore negative ndaj interesave të klientit ose të klientëve dhe ndaj kohëzgjatjes së procedurës. Administratori informon panelin përkatës për sa më lart.
7. Nëse vërtetohet se një anëtar i ekipit nuk i plotëson, ose pushon së plotësuari kriteret e kësaj pjese, Administratori mund të udhëzojë mbrojtësin që të pezullojë ose përfundojë kontratën me anëtarin e ekipit, ose të pezullojë apo përfundojë marrëdhënien e punës me anëtarin e ekipit, sipas rastit. Administratori informon panelin përkatës në lidhje me këtë, sipas rastit.
8. Mbrojtësi informon pa vonesë Administratorin për përfundimin e punës ose kontratës së çdo anëtarit të ekipit të vet dhe garanton që të gjitha dokumentet konfidenciale dhe rreptësisht konfidenciale t'i kthehen Mbrojtësit.
9. Mbrojtësi dhe ekipi i vet u përmbahen kushteve të sigurisë të përcaktuara në udhëzimet përkatëse të një paneli, të Kryetarit dhe/ose Administratorit.
10. Mbrojtësi mban një dosje të plotë dhe të saktë të të gjithë dokumentacionit lidhur me emërimin ose caktimin e mbrojtësit dhe përzgjedhjen e kontraktimit të anëtarëve të ekipit, si edhe për punën e kryer. Në varësi të detyrimeve të veta në bazë të Kodit të Etikës Profesionale për Mbrojtësit, mbrojtësi e ruan dosjen për pesë (5) vjet pas përfundimit të procedurës para Dhomave të Specializuara

Hagë, Holandë

28 prill 2021

Dr. Fidelma Donlon

Administratore